



01.Nr. 175-1/10

Më: 29.07.2010

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VIII-të (VII-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 24.6. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Refik Ramajt dhe Syzana Sylës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), Faruk Hajrizi, kryeshef ekzekutiv i ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Qazim Azemi- në emër të grupit asambleistë të AAK-së kërkoi që nga rendi i ditës të hiqet pika nr. 2 e rendit të ditës, pasi që nuk ka material për këtë pikë të rendit të ditës, duke kërkuar që kjo pikë të shqyrtohet në një seancë të veçantë duke përgatitur materialin e duhur për të. Gjithashtu pikat 8 dhe 11 të rendit të ditës të hiqen, pasi që këto vendime nuk kanë mbështetje të bazuar në Ligjin mbi tokat bujqësore, sepse toka e klasës 1,2,3 nuk lejohet t'i ndryshohet destinimi në tokë ndërtimore, duke shtuar se këto vendime nuk janë në interes të Komunës. Në vazhdim tha se ka qenë edhe më herët një vendim i Kuvendit për depon që është bërë prej 470 metra katror , dhe për fletën poseduese 198, dhe 40 ari për Komunën kadastrale Stanoc i Poshtëm, të cilën e përkrahim, por jo për tokën bujqësore 1.60 hektar. Pastaj kërkoi që të hyn pikë e re dhe të jetë e përhershme pyetjet e anëtarëve të Kuvendit. Në fund për pikën “të ndryshme” propozoi që të shqyrtohet kërkesa e lagjeve “Hamiti dhe Ferizi” të cilat kanë bërë kërkesë dhe kanë paraqit projekt në këtë Komunë.

Besim Jashari- paraqiti vërejtje për mungesën e procesverbalit nga seanca e jashtëzakonshme.

Sabit Kadriu- kërkoi që në seancën e radhës të vjen komandanti i policisë dhe të raportoi për çështjen e sigurisë. Gjithashtu kërkoi që të vazhdohet me shtruarjen e asfaltit deri në Novolan.

Sami Istrefi- grupi asambleistë i PDK-së e mbështet këtë rend dite, duke arsyetuar në vazhdim rendin e ditës.

Muharrem Shabani- tha që pajtohet se mungon procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, e që është dashtë të jetë. Pastaj tha se do të ishte mirë që të ketë material për pikën nr. 2 të rendit të ditës, duke shtuar se do të duhej që ndërmarrjet komunale të na njoftojnë për stafin menaxhues, bordin menaxhues, të hyrat, të dalurat, kapacitetet, për situatën e tërësishme, dhe të gjitha këto të jenë me shkrim. Mandej tha se do të duhej të njoftohemi për çështjen e fabrikës së ujit. Ndërsa lidhur me ndërrimin e destinimit të pronave, tha se pronat janë të Komunës, prandaj menaxhimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë ligjore. Në vazhdim bëri fyerje ndaj një anëtarit të Kuvendit nga radhët e PDK-së. Pastaj tha se është obligim të ruhet toka bujqësore, dhe si grup asambleistë janë kundër ndërrimit të destinimit të kësaj prone, pa ndonjë arsyetim të veçantë, sepse këto prona nuk kanë kaluar nëpër KPF, nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Komunës, prandaj duhet të hiqen deri sa të bëhet arsytimi dhe të merret mendimi edhe i Ministrisë së Bujqësisë për këtë çështje.

Sami Istrefi- tha se të gjithë anëtarët e Kuvendit kemi dhënë betimin për t'iu shërbyer interesave të qytetarëve, por jo fyerjeve personale, pasi që nuk është në etikën morale, njerëzore, kombëtare që ta fyejmë njëri tjetrin. Në vazhdim njoftoi se edhe grupi asambleistë i PDK-së i mbështet mediat për të përcjellur seancat e Kuvendit, duke njoftuar se ka pasë kontratë me TV Mitrovicën. Ndërsa lidhur me pronat, tha se ato prona shfrytëzohen në mënyrën më të egër, duke njoftuar se dikush aty merr qira, por Komuna nuk ka qasje, prandaj për t'i parandaluar këto veprime të kundërligjshme, Komuna dhe ky Kuvend merr përgjegjësi që ato zona t'i trajtoj në mënyrën më të mirë duke iu mundësuar bizneseve që ato të ushtrojnë funksionin e tyre në ato hapësira.

Shpëtim Zhegrova- lidhur me fyerjen që e bëri M.Shabani, shprehu keqardhje që iu bë fyerja në mënyrë të padrejtë, pasi që u betua se nuk ka folur fare nga vendi.

Bahrije Pllana- në emër të grupit asambleistë të AAK-së kërkoi falje dhe e tërheqim fjalën paraprake të anëtarit tonë të Kuvendit.

Sabit Kadriu- tha se çështjen për lagjet "Ferizi dhe Hamiti" e kanë shtruar në disa seanca, por nuk është futur në prioritet, prandaj duhet të diskutohet dhe të futet në prioritet.

Ferit Idrizi- sqaroi se buxheti i seancës së kaluar ka qenë rishikimi i buxhetit, kurse planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm do ta aprovojmë në Kuvend së bashku. Pastaj me që ka qenë seancë e jashtëzakonshme, ka bazë juridike që të vazhdojmë punimet me këtë seancë, dhe në seancën e ardhshme na vjen procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, pra nuk ka ndonjë shkelje juridike. Në vazhdim tha se pajtohem që pika nr. 2 e rendit të ditës mund të futet si "Informatë". Sa i përket pikës nr. 7, njoftoi se kemi marrë një vendim të Kuvendit, por ai vendim duhet të plotësohet sepse nuk e kemi qitur afatin për sa vite të jepet në shfrytëzim, dhe këto prona janë duke i shfrytëzuar të tjerët në mënyrë ilegale, duke mbledhur edhe taksa të paligjshme.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 25 vota "për" , 7 "kundër", të tjerët "abstenim" , aprovoi këtë:

Pika nr. 2 të emërohet si "Informatë", kurse në "të ndryshme" të futen pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të datës 27.05.2010.

2. Shqyrtimi i gjendjes së furnizimit me ujë të pijes nga rrjeti i ujësjellësit në Komunën e Vushtrrisë.

3. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake buxhetore për muajin maj/2010.
4. Shqyrtimi i qarkores buxhetore të MEF-it për buxhetin e komunës për v.2011.
5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme.
6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat fillore të komunës.
7. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e ciklit të mesëm të ulët të komunës.
8. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për shpalljen e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës komunale.
9. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për dhënien me koncesion të pronës së paluajtshme të komunës.
10. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për plotësim të vendimit të KK-së për ndryshim të rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
11. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për plotësim të vendimit të KK-së për shpalljen e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës.
12. Eventuale.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, të datës 27.05.2010.

Qazim Azemi- faqe 4, pika 9, tha se mungon deklarimi ynë i votimit “kundër”, prandaj kërkoi që të futet në procesverbal deklarimi ynë “kundër” tenderimit të pronës komunale të tokës bujqësore pa kaluar nëpër procedurat ligjore.

Edhe pse nuk kishte vërjetje për ndonjë mangësi në procesverbal, në këtë pikë të rendit të ditës paraqiti këtë qëndrim:

Pajazit Pllana- tha se pyetja e tij është parashtruar sepse është një problem duvioz, duke kërkuar që brenda një afati kohor të bëhet një vlerësim, të ipet një përgjigje se ku kemi gypa të azbestit dhe Komuna ka obligim që këtë punë ta kryej për shkak se azbesti është substancë kancerogjene, e cila e rrezikon shëndetin e qytetarëve tanë, dhe para se të ndërtohet fabrika e ujit, të kryhet ky problem në tërë territorin.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet njëzëri procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtjen e Q.Azemit.

2. Shqyrtimi i gjendjes së furnizimit me ujë të pijes nga rrjeti i ujësjellësit në Komunën e Vushtrrisë.

Faruk Hajrizi- tha se në bazë të ligjit për ndërmarrjet publike kompania regjinole e ujësjellësit në Mitrovicë është menaxhuese edhe e rrjetit por edhe e furnizimit me ujë të pijshëm. Në vazhdim njoftoi se edhe pse ka ardhur rishtas në këtë pozitë, ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme së bashku me bordin e ri për të furnizuar Vushtrrinë me ujë, dhe shtoi se që nga muaji gusht i vitit të kaluar furnizimi me ujë i Komunës së Vushtrrisë është në proporcion me numrin e banorëve të Komunës, dmth mbi 150 litra ujë për çdo ditë për kokë banori. Pastaj njoftoi për masat e reja që do të merren për furnizimin më të mirë me ujë për Komunën e Vushtrrisë. Gjithashtu informoi se në Mitrovicë po ndërtohet fabrika e re e ujit me kapacitet prej 700 litra ujë në sekondë, gjë që me ndërtimin e fabrikës së ujit në Vushtrri edhe qytetarët e Vushtrrisë do të furnizohen 24 orë me ujë.

Zeqir Hasani- sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm në Vushtrri, tha se nuk plotësohet kurrfarë standardi me ujë të pijshëm, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë është më e diskriminuara në mesin e tri komunave sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, duke shtuar se në temperaturat e larta nuk ka ujë më shumë se një orë.

Veli Karaça- tha se me përshkrimin dhe me konstatimin e gjendjes nuk mund të ndryshojmë për të mirë asgjë. Pastaj tha se ka lagje që çdo 2 apo 3 ditë vjen uji në sasi shumë të vogël dhe në një kohë shumë të shkurtër. Në vazhdim tha sasia e paraqitur e ujit nga kryeshefi regjional nuk arrin në Vushtrri, pra problemi është tek diskriminimi dhe keqmenaxhimi i ujit, pasi që nëse fabrika punon me kapacitet të plotë prej 600 litra në sekondë, atëherë ka mundësi ta zbut problemin e furnizimit të Vushtrrisë me ujë, nëse uji ndahet në mënyrë proporcionale. Mandej tha se nëse e tërë kjo sasi i dedikohet Vushtrrisë, duke mos qenë në mënyrë kontinuele, por vjen çdo të dytën ditë, shprehu dyshimin se ku mund të akumulohet e tërë kjo sasi e ujit, kur kapaciteti i rezervuarit është 10.000 metra kub. Gjithashtu tha se Komuna e Vushtrrisë është e diskriminuar edhe sa i përket pagesës së ujit, duke paguar ujin e shpenzuar në regjion, pasi që paguajmë paushall sikur ata që furnizohen 24 orë me ujë çdo ditë. Pastaj është rrezik edhe prej sëmundjeve ngjitëse, pasi që gypat dhe rezervuari janë shumicën e kohës të zbrazëta, dhe gjatë kësaj kohe vjen deri te korodimi, sidomos gypat që janë prej azbestit. Në fund kërkoi që të monitorohet prej një organi të pavarur sasia e ujit që vjen në rezervuarin e ujit në Vushtrri për një periudhë të caktuar dhe të vërtetohet se kjo sasi nuk është ajo që po deklarohej këtu, sepse nuk është e vërtetë që qytetarët e Vushtrrisë që janë të kyçur në ujësjellës furnizohen brenda ditës me 150 litra ujë.

Sami Istrefi- tha se që nga paslufta deri në vitin 2004 udhëheqja e atëhershme ka qenë më famëkeqe sa i përket furnizimit të Vushtrrisë me ujë të pijshëm, sepse ajo udhëheqje nuk ka qenë bashkëpunuese as me institucionet e Komunës, as me qytetarët, as me degën e njësisë në Vushtrri. Duke iu referuar kryeshefit regjional që tha se përqindja e ujit ndahet për kokë të banorit, shtoi se nuk është ashtu për shkak se vetëm veriu i Mitrovicës furnizohet me 24 % ujë pandërprerë kualitativ, kurse tri komunat: Mitrovica, Skenderaj dhe Vushtrri kanë mbetur në mëshirë të fatit. Në vazhdim tha se menaxhmenti i ri kur ka ardhur në vitin 2009 ka qenë bashkëpunues me institucionet e Komunës, dhe ka shprehur përkrahjen ligjore, duke bërë përpjekje për ta pasë përqindjen e merituar në furnizim me ujë të pijshëm, por në tre muajt e fundit nuk jemi duke u furnizuar siç duhet. Gjithashtu tha se Komuna e Vushtrrisë është duke paguar një faturë shumë të keqe me ndërmarjet që nuk i menaxhon, siç është Uniteti, Ujësjellësi regjional dhe KEK-u. Pastaj bëri të ditur që Kuvendi i Vushtrrisë ka miratuar një rregullore e cila i sanksionon keqpërdoruesit e ujit të pijshëm gjatë stinës së verës.

Ismet Gashi- sa i përket çështjes së furnizimit të Komunës së Vushtrrisë me ujë të pijshëm, tha se Komuna e Vushtrrisë nuk është e furnizuar gati fare. Duke iu referuar kryeshefit regjional i cili njoftoi se në Komunën e Vushtrrisë furnizohen qytetarët me 150 litra ujë për kokë banori çdo ditë, pyeti se a është punë e kryer për juve nëse prej ujësjellësit regjional ndahen ato 150 litra, apo duhet të përcjellen deri sa të vijnë në rezervuarin e Vushtrrisë ku bëhet shpërndarja dhe çfarë masa ju parashihni që ai ujë të vjen deri aty ku duhet që të shpërndahen ato 150 litra, pasi që uji i pijshëm shpërndahet nëpër ara, pa ardhur fare në ujësjellës.

Habibe Gërxhaliu- pyeti se sa është i pastër uji për pije, pasi që nëpër rezervuar krijohet një shtresë e baltës?

Besim Jashari- tha se problemi i furnizimit me ujë është shumë serioz dhe kërkon një seriozitet të jashtëzakonshëm. Pastaj tha se kjo sasi e ujit kur vjen, ka raste kur të krijon përshtypjen sikur me qenë erë e barërave, dhe erë myku, prandaj duhet me marrë shumë seriozisht në mënyrë që të parandalohet ndonjë epidemi. Në vazhdim propozoi që të shikohet mundësia që kjo sasi e ujit që po vjen të përdoret më racionalisht dhe atyre që nuk kanë fare qasje në ujë, t'iu mundësohet në mënyrë më

të njerëzishme ta marrin sasinë e ujit. Pastaj tha se ka raste kur nga fshatrat vijnë të marrin ujë në qytet pasi që në qytet uji nga ujësjellësi është më i pastër, dhe kërkoi që të krijohet një vend i përshtatshëm në qytet që t'iu mundësohet me marrë ujë në mënyrë më të përshtatshme.

Pajazit Pllana- tha se çështja e ujit është jetike, pasi që pa ujë nuk ka jetë. Pastaj paraqiti tri pyetje: a po kontrollohet uji nga Instituti kombëtar i shëndetit publik në aspektin bakteriologjik, kimik dhe a i plotëson nevojat që njeriu ta konsumoj dhe ta përdorë? Gypat të cilët ujësjellësi mbetet pa ujë janë burim i infeksionit dhe burim i të keqes për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, prandaj pyeti cila është zgjidhja juaj që qytetarët e Vushtrrisë të kenë ujë dhe shtoi se ku po mbetet uji?

Muharrem Shabani- tha se çështja e furnizimit të Vushtrrisë me ujë është problem edhe i paraluftës. Pastaj tha se nëse është zgjeruar sasia e prodhimit të ujit, Vushtrria nuk merr sasinë që u paraqitën, por ndoshta te Shipoli ku bëhet ndarja dhe kyçja në gypin kryesor mund të matet se hyjnë aq, mirëpo gjatë trasesë së rrugës ka shumë kyçje ilegale deri në Komunën e Vushtrrisë, prandaj kërkoi të informohet se sa ujë hyn në rezervuar, e jo sa vjen prej Shipoli, sepse nuk është barometër real me vërtetuar se na marrim aq ujë. Mandej ujësjellësi ndoshta edhe sot është i politizuar, duke kërkuar që të bëhet ndarja e barabartë e sasive të ujit nga ujësjellësi regjional dhe trajtimin e barabartë të të gjitha komunave. Në fund tha se është i nevojshëm koordinimi dhe bashkëpunimi në zgjidhjen më të mirë të çështjes së ujit, duke kërkuar të informohen se sa ka ujë në rezervuarin e Vushtrrisë.

Faruk Hajrizi- tha se të gjitha informatat i ka për rezervuarin e Vushtrrisë, duke shtuar se për muajin maj 80.000 metra kub kanë hyrë në rezervuarin e Vushtrrisë, edhe 72.000 janë shpërndarë nëpër rrjet, dhe kjo sasi e ujit nuk ka të bëjë asgjë me Shipolin. Kurse në vazhdim sqaroi se si ndahet sasia e ujit nëpër tri komunat. Ndërsa lidhur me kualitetin e ujit të pijshëm, tha se analizat ditore bëhen në Institutin e shëndetësisë publike në Prishtinë dhe ato analiza nuk kanë dalur asnjëherë negative. Sa i përket ujëmatësve, tha se ujëmatësit më të ri janë vendosur në Vushtrri, mirëpo nuk është në kompetencën e tij që ta kontrollojë keqpërdorimin e ujit nga qytetarët e ndryshëm. Në vazhdim tha se pasi që kemi rritur orët e furnizimit me ujë për qytetarët, ka rënë numri i të interesuarëve për pagesën e ujit. Sa i përket gypave, tha se ka siguruar një donacion nga Qeveria e Luksemburgut, përmes të cilit do të shfrytëzohen lidhjet e gypave për furnizim kontinuel dhe më të mirë me ujë të pijshëm.

Xhevahire Izmaku- tha se mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm është një sfidë me të cilën janë ballafaquar të gjitha qeveritë komunale në Vushtrri që nga pas lufta. Pastaj njoftoi se në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv të ujësjellësit, me drejtorin e inspeksionit, me policinë, dhe me përfaqësuesin e njësisë së ujësjellësit në Vushtrri kemi krijuar një ekipë e cila po mundohet të menaxhon brenda 24 orëve dhe të gjen keqpërdoruesit e ujit në Vushtrri, që është një nga elementet që ka krijuar këtë kaos momental. Në vazhdim informoi se për ndërtimin e fabrikës së ujit në Vushtrri Qeveria e Kosovës ka ndarë 5 milionë euro, tenderi i hapur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave është një tender ndërkombëtar, dhe me 1 korrik do të mbyllet oferta e tenderit, duke shtuar se ka kompani të fuqishme ndërkombëtare që kanë aplikuar dhe janë të interesuara të ndërtojnë fabrikën.

3. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake buxhetore për muajin maj/2010.

Zeqir Hasani- paraqiti vërejtje sa i përket paisjeve të bizneseve me leje pune, duke shtuar se në bazë të raportit nga 1.261 biznese deri më sot nuk janë pajis me leje pune as 10 %, dhe kërkoi shpejgim dhe kërkoi angazhim më të madh për të pajisur bizneset me leje pune. Kurse sa i përket aktiviteteve për parandalimin e keqpërdorimit të ujit, nuk ka asnjë të hyrë apo marrjen e ndonjë mase për t'u

gjebitur dikush për keqpërdorim të ujit, kur dihet sa keqpërdorues të ujit janë në Komunën e Vushtrrisë. Ndërsa sa i përket mbledhjes së të hyrave nga tatimi në pronë që ka shënuar një rritje të madhe, tha se këto të hyra janë të dedikuara 100 % në rregullimin e infrastrukturës, prandaj kërkoi që të bëhet një plan investues duke u bazuar në mbledhjen e të hyrave nga zonat e caktuara, pasi që ka zona të caktuara që e paguajnë rregullisht tatimin në pronë, kurse investimet në ato zona mungojnë, dhe kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të kemi një raport mbi pagesën e tatimit në pronë nëpër fshatra.

Besim Jashari- tha se në seancën e jashtëzakonshme ka qenë rishikimi i buxhetit, duke shtuar se rishikimi i buxhetit është diçka shumë serioze, është një analizë e përgjithshme për tërë atë që është planifikuar, se a është duke u realizuar, a janë duke dalë të dalurat sipas planit që janë paraparë. Në vazhdim tha se nëse informata në fjalë ka shkuar përmes Kryetarit të Komunës, atëherë këtu po figuron se Kryetari nuk e ka parë këtë informatë, përndryshe do ta kishte nënshkruar. Pastaj tha se informata po tregon se është tejkualuar plani, mirëpo në faqe 5 thuhet se të hyrat nga donatorët, duke pyetur se mbi ç'bazë është saktësuar në mënyrë kaq precize shifra e donacioneve, kurse realizimi është 40.000.

Sami Istrefi- tha se grupi asambleistë i PDK-së e mbështet këtë informatë pasi që kemi një rritje të të hyrave në raport me planifikimin. Në vazhdim tha se është hera e tretë që po kërkon të inkasohen gurthyesit, pasi që këtu nuk kemi asnjë taksë, asnjë të hyrë. Pastaj kërkoi që të shpjegohet se në cilën formë po bëhet planifikimi dhe realizimi, dhe a po mbledhen nga të gjitha shtyllat e administratës së Komunës, pasi që këtu janë paraqitur të hyrat vetëm nga tri kategori.

Zeqir Hasani- tha se shtetet e bashkësisë evropiane kurrë nuk planifikojnë mbledhjen e të hyrave, prandaj sugjeroi Drejtorinë e Buxhetit që të bëjnë përpjekje sa më të mëdha në mbledhjen e të hyrave sa më të mëdha dhe të mos kufizohen vetëm në të hyrat që janë përcaktuar në bazë të buxhetit qendror, pasi që sa më shumë të hyra të ketë Komuna e Vushtrrisë, aq më shumë do ta rregullon infrastrukturën e vet.

Sabit Kadriu- paraqiti vërejtje për formën e paraqitur të përshkrimit të tabelave, duke propozuar një metodë tjetër , në mënyrë që të jetë më e qartë dhe më e kuptueshme për t'u orientuar.

Pajazit Pllana- tha se ka një rënie në raport me vitin e kaluar tek regjistrimi i automjeteve, dhe pyeti pse ka ndodh kjo? Gjithashtu ka rënie rreth vjeljes së participimit në mjekësinë primare, prandaj kërkoi shpjegim pse ka rënie dhe ku qëndron që vjelja në nivelin primar ka rënie më të theksuar se sa në vitin e kaluar.

Isuf Jashari- sa i përket inkasimit të të hyrave në muajin maj, tha se ka qenë një inkasim më i mirë krahasuar me vitet e kaluara, mirëpo ka mundësi që të inkasohen edhe më shumë të hyra dhe çdo muaj do të jetë më i favorshëm në inkasimin e të hyrave vetanake. Kurse sa i përket pyetjeve të Z.Hasanit, u përgjigj se janë duke punuar në vazhdimësi për t'i pajisur bizneset me leje pune, mirëpo një numër i madh i subjekteve afariste nuk i plotëson kërkesat për t'u pajisur me leje pune, prandaj atyre iu japim leje të përkohshme për zhvillimin e biznesit të tyre. Ndërsa lidhur me pyetjen e B.Jasharit, tha se asnjëherë nuk e ka dëgjuar duke dhënë një vizion se si të inkasohen të hyrat, por çdo herë flet vetëm për gabimet teknike. Lidhur me pyetjen e S.Kadriut, u përgjigj se formulari është i qartë, pasi që në fillim shënohet planifikimi, pastaj realizimi i muajit paraprak dhe realizimi i këtij muaji, në fund janë indeksat të cilët tregojnë krahasimin me vitin paraprak. Kurse sa i përket pyetjeve të P.Pllanës, u përgjigj se te regjistrimi i automjeteve të hyrat variojnë, disa muaj është më e madhe, disa më e vogël, pasi që ajo është kompetencë e qytetarëve se a dëshirojnë ta regjistrojnë automjetin apo jo, ndërsa lidhur me të hyrat në shëndetësi, tha se në disa muaj është shumë më i mirë dhe e tejkalon planifikimin, e disa muaj është më i vogël.

Besim Jashari- sugjeroi se në pjesën ballore të shkresës kur thuhet përmes Kryetarit, atëherë duhet konsultuar dhe duhet marrë miratimin e Kryetarit. Pastaj inspektimi i ambientit nuk ka pasë asnjë të hyrë, asnjë gjobë, prandaj propozoi që Drejtoria e Buxhetit të bashkëpunon me inspeksionin, por paraprakisht drjetori i buxhetit le të bashkëpunon me stafin e vet pasi që vetëm 10 % të bizneseve janë të pajisur me leje, prandaj le ta gjen mënyrën për të inkasuar të hyra nga pajisjet e bizneseve me leje pune. Gjithashtu propozoi që të bashkëpunon me drejtorin e shëndetësisë dhe le të shikohet mundësia se si të përmirësohet inkasimi.

4. Shqyrtimi i qarkores buxhetore të MEF-it për buxhetin e komunës për v.2011.

Isuf Jashari- paraqiti sqarimet hyrëse.

Zeqir Hasani- tha se qarkore buxhetore dmth se mjetet janë të specifikuar dhe janë të limituara, prandaj na mbetet që ato mjete t'i destinojmë nëpër programe të caktuara në bazë të prioriteteve. Në vazhdim tha se nuk kemi asnjë informacion nëse është formuar një komision i ekspertëve që është i paraparë dhe i dispozituar prej Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Pastaj tha se Komuna e Vushtrrisë edhe me këtë qarkore buxhetore është e dëmtuar në furnizim me grante, pasi që edhe në këtë qarkore buxhetore figuron popullata 75.000. Kurse sa i përket tabelave, shtoi se grantet për investimet kapitale për tri vitet e ardhshme mbesin përafërsisht të njëjta, pra kemi një investim në rregullimin e infrastrukturës dhe çështjeve tjera jetike për qytetarët shumë më të vogël se që është premtuar. Sa i përket tabelës në fund, tha që mjete apo grante shtesë nuk ka, prandaj kjo qarkore buxhetore duhet të diskutohet me qytetarët, në mënyrë që ata të njoftohen se sa ka mjete për vitet e ardhshme Komuna e Vushtrrisë për rregullimin e jetës së tyre.

Besim Jashari- tha që kjo qarkore do të duhej të ishte pjesë e bashkangjitur e një Informate që do ta përgatiste Drejtoria e Buxhetit dhe Thesarit, pasi që kjo qarkore iu është drejtuar kryetarëve të komunave, drejtorëve për buxhet dhe drejtorëve të drejtorive komunale, e jo neve. Pastaj kërkoi që të kyçen edhe partnerët tjerë në debat lidhur me buxhetin, pasi që një vendim që merret për buxhetin, përgjegjësia bjen edhe mbi ta për rezultatit që e arrijmë.

Qazim Azemi- pasi që jemi Komunë rurale, propozoi që ta kemi ndonjë grant për zhvillimin e bujqësisë.

Sabit Kadriu- kërkoi që nga tabelat e 38 komunave, drejtorati t'i veçoj vetëm për Komunën e Vushtrrisë të hyrat për administratë, arsim, për të gjitha. Pastaj pyeti se a janë të gatshme projektet për prioritetet. Në fund propozoi që të formohet një grup i ekspertëve dhe t'i diferencojnë cilat kanë qenë të hyrat buxhetore për vitin 2010, dhe cilat duhet të jenë për vitin 2011 dhe prioritetet e Komunës duke ofruar edhe projektet.

Sami Istrefi- tha se kjo komunë dëmtohet shumë që nga viti 2003 për nga numri i popullësisë që iu është dhënë. Pastaj kërkoi që 1,315.000 € të ndahen në të gjitha kategoritë, e jo vetëm në tri shtylla.

Muharrem Shabani- duke iu referuar statistikave që janë paraqitur nga Ministria, tha se Komuna e Vushtrrisë ka më pak të hyra se disa komuna që kinse kanë më shumë banorë, mirëpo fazat dhe hapat që duhet të ndërmerren me nxjerrjen e planit ka nevojë për përkrahje. Në vazhdim tha se në qarkoren e dytë të vitit të kaluar që u miratua në shtator janë paraqitur shumë projekte që nuk po përputhen as në vitin 2010, dhe as në 2011 nuk do të realizohen si të tilla, nëse nuk jemi të gatshëm të thithim investime në bazë të partneritetit dhe konferencës së donatorëve, dhe shtoi se një hendikep është edhe mungesa e Kryetarit të Komunës në këtë seancë, pasi që ai është përgjegjësi kryesor për buxhet.

5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme.

Idriz Ismajli- paraqiti sqarimet hyrëse.

Sami Istrefi- tha se neni 20.2 duhet të ndryshohet, dhe propozoi që afati të jetë prej 1-5 vjet. Pastaj neni 21, tek pika 6, duhet të thuhet “në rast të dhënies me qira”, e jo të shitjes.

Ismet Gashi- tha se nuk ka nevojë të ekziston fare neni 4, pasi që me plan urban nuk janë të parapara destinimet e sipërfaqeve për objekte të përkohshme. Poashtu kërkoi që të hiqet neni 5.5. Neni 8, tha se nuk ka nevojë të miratohet konkursi, pasi që janë kriteret në nenin 11. Neni 22, duhet të harmonizohet. Neni 23 rregullon diçka tjetër, por duhet të jetë neni 21. Neni 23 dhe 31 janë përafërsisht të njëjtë, dhe duhet të hiqet se ka të bëjë me kushtet urbanistike. Neni 38 duhet të thirret në nenin 37, e jo 45. Neni 42, pika 1, duhet të përmirësohet dhe të thuhet “pa leje ndërtimi”. Në fund sugjeroi që ta ketë një dispozitë shtesë, që të bëhet rregullimi, trajtimi i objekteve të cilat janë të vendosura me leje ndërtimi, pra për objektet ekzistuese.

Besim Jashari- tha se pasi që po nxirret një rregullore lidhur me shfrytëzimin e përkohshëm të tokës që është në pronësi komunale, kishte me qenë mirë që me filluar me identifikuar se cila është prona komunale e uzurpuar.

Muharrem Shabani- tha se kjo rregullore nuk vlen vetëm për qytetin e Vushtrrisë, por për Komunën e Vushtrrisë, prandaj në nenin 17.1 duhet të ndryshohet dhe të jetë për Komunën e Vushtrrisë, e jo për qytetin e Vushtrrisë.

Esat Beka- tha se e përkrah këtë draft-rregullore, pasi që tash e 10 vite Komuna e Vushtrrisë nuk vjelë asnjë taksë prej këtyre pronave, pasi që shfrytëzohen këto prona nga njerëzit jokompetentë. Pastaj kërkoi që të lirohen nga disa taksa tri kategoritë e dalura nga lufta e fundit.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Që draft-rregullorja në fjalë të ipet në diskutim publik në afat të caktuar ligjor.

Në vazhdim u diskutuan së bashku këto dy pika të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat fillore të komunës.

7. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e ciklit të mesëm të ulët të komunës.

Vlora Qirezi- në emër të grupit asambleistë të LDK-së propozoi që kjo rregullore të afishohet dhe t’iu dërgohet të gjitha shkollave të Komunës, në mënyrë që t’iu ipet mundësia edhe këshillave të shkollave të japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Qazim Azemi- tha se këto dy rregullore janë nismë e mirë për arsimin. Sa i përket rregullores së parë e përkrahin me disa vërejtje, duke kërkuar që neni 6 të plotësohet edhe me atë që këshilli i klasëve të përbëhet edhe prej mësuesëve dhe arsimtarëve përkatës të shkollës, si dhe të përmendet një aline se kush e udhëheqë këshillin e klasës, e që duhet të jetë kryetar i këshillit të klasës, që zgjidhet në këshillin e arsimtarëve. Gjithashtu nenit 13 duhet t’i shtohen disa aline dhe kriteret rreth shpërblimit, mirënjohjeve dhe kupave që ipen për nxënësit. Neni 16 të mos jetë i përgjithësuar, prandaj kërkoi të bëhet regjistrimi i tyre, dhe që të ketë tretman të veçantë për këtë kategori, të mos ketë shkollë speciale vetëm në qytet, por të ketë edhe nëpër fshatra. Kurse tek rregullorja e dytë, propozoi që para nenit 7-të të ketë një kapitull që flet për shpërblime dhe mirënjohje për arsimtarët dhe stafin, që të jetë një stimulim. Gjithashtu paraqiti vërejtje se në rregullore mungon përmendja e organeve qeverisëse dhe komunale, duke kërkuar që në rregullore të figurojnë edhe këshilli i nxënësve, këshilli i arsimtarëve, këshilli i klasëve dhe aktivitetet profesionale. Në vazhdim propozoi që të jetë një nen i veçantë rreth ushqimit të këtyre nxënësve nëpër shkolla.

Selvete Sholla- tha se është pozitive që kjo rregullore do të vlen për të gjitha shkollat. Pastaj tha se kjo rregullore është e bazuar në Ligjin për Arsim Fillor dhe të Mesëm të Kosovës, dhe propozoi që të shkon në diskutim publik, t’iu shpërmdahet të gjithë drejtorëve të shkollave fillore, të merren parasysh vërejtjet e arsyeshme, duke shpresuar që kjo rregullore do të zbatohet prej fillimit të vitit të ri shkollor. Në fund paraqiti vërejtje tek neni 17.4 duke propozuar që të shtohet fjalia “edhe jashtë objektit shkollor”, dhe kërkoi që të mos i imponohet nxënësve të vet që të ndjekin kurse nga mësimet me qëllime fitimprurëse.

Pajazit Pllana- paraqiti vërejtje për nenin 21.3, pasi që në shkollat e Komunës sonë dhe të Kosovës mjek shkollor nuk ka, as ambulanta shkollore nuk ka, prandaj propozoi që këtu të jetë specialisti i mjekësisë familjare dhe pediatri. Gjithashtu propozoi që të ketë një komision mjekësor ose t’iu bëhen vizita sistematike të gjithë punëtorëve të arsimit për vlerësimin e aftësive të tyre punuese dhe gjendjen faktike në Komunën e Vushtrrisë.

Sabit Kadriu- tha se kjo rregullore ka shumë mangësi, prandaj para se të kalon në diskutim publik, para se të kalon nëpër shkolla, kjo rregullore është mirë të ripunohet edhe një herë, sepse nuk bazohet mbi parime metodike dhe mbi parime pedagogjike. Pastaj kjo rregullore ka të meta të shumta në aspektin drejtshkrimor dhe sintaksor, pasi që nganjëherë fjalitë janë konfuze. Në vazhdim tha se në këtë rregullore nuk janë të precizuara, edhe pse me ligj janë të precizuara detyrat e drejtorit, përgjegjësitë e drejtorit, obligimet e drejtorit, dhe rastet kur ndërrohet drejtori, poashtu mungojnë obligimet dhe detyrat e zëvendës drejtorit, mandej cilat janë përgjegjësitë për arsimtarët, për nxënësit.

Bahrije Pllana- tha se këto rregullore paraprakisht janë analizuar shumë seriozisht nga të gjithë anëtarët e KPF-së, duke shtuar se ka munguar drejtori i arsimit, por kanë qenë prezent zyrtarët e tij, të cilët i kanë përpiluar këto rregullore, pra rregullorja ka ardhur në KPF pa e lexuar drejtori fare. Në vazhdim paraqiti vërejtje që nuk po inkorporohen të gjitha vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e KPF-së, prandaj i sugjeroi Kryesuesit të Kuvendit që para se me ardhë materialet në KPF dhe në Kuvend të shikohen a janë inkorporuar vërejtjet, e pastaj të nënshkruhen.

Sami Istrefi- e mbështeti atë që e tha parafolësja. Pastaj tha se forma e përpilimit të rregullores së parë nuk e meriton të diskutohet në Kuvend, asnjë konditë ligjore nuk i përcakton kriteret e një rregulloreje, dhe nëse krahasohet me rregulloren e dytë, lind dyshimi se a janë përpiluar këto dy rregullore në Drejtorinë e Arsimit, a ekzistojnë dy komisione të veçanta. Pastaj tek neni 3, propozoi që të hiqet, dhe të lihet “i popullit shqiptar”.

Xhylsime Feka- kërkoi nga drejtori që kur të hartohet një rregullore e tillë që është shumë e domosdoshme, të konsultohet Zyra ligjore pranë drejtorisë, pasi që shumë gjëra janë në rregullore që gjenden në ligj, prandaj nuk kanë nevojë që të përsëritën në rregullore. Në vazhdim kërkoi që të këshillohet edhe me Komitetin Konsultativ për Arsim. Pastaj tha se nuk ka nevojë me qenë në rregullore neni 17, pika 18.1, 18.2, 18.3, pasi që këtë shumë mirë e definon ligji. Tek neni 21, tha se nuk e din se çka ka të bëjë këtu stafi profesional dhe civil në shkollë.

Esat Beka- lidhur me draftrregulloren nga klasa 6 deri në të 9-tën, paraqiti vërejtje tek pika 6.8. Poashtu nuk janë përcaktuar masat për menaxhmentin, nëse nuk zbatohet rregullorja, apo nuk i punon punët në bazë të ligjit të arsimit, prandaj propozoi që të futen masat ndaj menaxhmentit.

Habib Mustafa- tha se këto dy rregullore janë bazuar në Ligjin për Arsim dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Pastaj tha se ka vërejtje për këto rregullore, por mirë që është nis të punohen këto rregullore, pasi që shkollat janë pa rregullore. Në vazhdim duke i referuar draftrregullores për shkollat e mesme të ulta, të drejtat e mësimdhënësit, pika 18.3, tha se nuk e ka kuptuar. Mandej lidhur me masën vërejtje me gojë, pyeti pse t’iu shqiptohet kjo masë, kur ai veç është i sëmure pa vullnetin e vet. Tek masa disiplinore ndalim i avancimit deri në tre vjet, pika 20.28, shtoi se kur

të asgjëson dokumentacionin shkollor, duhet të jetë masë më e rëndë. Pastaj për pikën 20.28 tha se nuk është masë adekuate.

Qazim Azemi- tek draftregullorja për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të ulta, propozoi të neni 20 të hiqet pasusi 20.23, sepse kur e bën këtë gabim mësuesi duhet të shkon në burg, e jo t'i ipet vërejtje me shkrim.

Habibe Gërxhaliu- tha se neni 9 është shumë mirë, por lidhur me masat ndaj nxënësve, shtoi se shumë pak janë marrë masa ndaj nxënësve. Pastaj tek regjistrimi i nxënësve në klasët e para, nuk është caktuar askund deri sa mundet me qenë numri i nxënësve në klasë dhe a është në dëshirën e prindit të caktoj mësuesen. Gjithashtu kërkoi që të mos jetë prezent mësuesi apo mësuesja gjatë regjistrimit të nxënësve. Në fund tha se në shkollën tonë nuk ka pedagog, psikolog, as mjek shkollor, dhe propozoi që të formohet një komision për regjistrimin e nxënësve në klasët e para.

Besim Jashari- tha se i mbështet të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë nga kolegët paraprak. Pastaj lidhur me pjesën kryesore të rregullores për arsimin fillor pyeti se kujt i propozon Kuvendi i Komunës, sepse dikush duhet me na propozuar neve si Kuvend, dhe i njëjti gabim përsëritet edhe tek rregullorja për arsimin e mesëm të ulët. Gjithashtu tha se Komiteti Konsultativ për Arsim është mandatuar nga Kuvendi që Drejtorja për Arsim paraprakisht t'i thërret dhe të këshillohet me ta në mënyrë që propozimet të vijnë sa më të kompletuar.

Ferit Idrizi- tha se në bazë të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, këshillat e shkollave duhet me propozuar draftregullore, kurse Kuvendi Komunal me i aprovuar, por pasi që e dijmë qysh e kemi gjendjen, jemi detyruar që na ta marrim këtë nismë, pasi që shkollat nuk kanë rregullore të punës nga Kuvendi, duke shtuar se nuk kanë as në komunat tjera të Kosovës. Pastaj njoftoi se një herë iu është kthyer Drejtorisë së Arsimit pasi që ka pasur shumë defekte, dhe prap na ka ardhur, prandaj tha që të dy draftregulloret, përveç 10 neneve të para që mund të kenë divergjencë, tërë nenet tjera mund të jenë identike, pasi që detyrat dhe përgjegjësitë e arsimtarëve janë të njëjta, prandaj nuk guxojnë këto që të mos harmonizohen, sikur të ishin punuar në dy komuna. Në vazhdim i numëroi se çka mungon e që duhet të ishte në të dy rregulloret. Në fund propozoi që të del në diskutim, t'iu dërgohet Komitetit Konsultativ për Arsim, drejtorëve të shkollave, në mënyrë që në seancën e radhës të na vijnë këto dy rregullore.

Qerim Selimi- njoftoi se në përbërje të komisionit janë të gjithë juristët që i ka në nivel të Drejtorisë së Arsimit dhe juristët që janë të shpërndarë nëpër shkolla. Pastaj njoftoi se këto rregullore janë punuar prej përgjegjësve të arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët, e jo nga komisioni.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 32 vota “për”, 1 “kundër”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Draftregulloret në fjalë ipen në diskutim publik në afat të caktuar ligjor.

8. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për shpalljen e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës komunale.

Nezir Klinaku- paraqiti sqarimet hyrëse.

Besim Jashari- shprehu keqardhje që në shumë raste vërejtjet që po japim nuk po merren seriozisht dhe nuk po përfillen. Pastaj tha se propozuesi i vendimit, pra Drejtorja e Kadastrit së pari duhet ta ketë një shkresë e cila thotë propozimvendim, pastaj duhet cituar dokumentet që e mbështesin propozimin.

Pajazit Pllana- tha se neni 2 i propozimvendimit duhet që në vend të afatit prej 15 viteve, të bëhet 10 vite, pasi që i jep shans biznesit a të zhvillohet, a të stopohet.

Ismet Gashi- në emër të grupit asambleistë të LDK-së propozoi që nga neni 2 të hiqet fjalia “veprimtari të ndryshme shërbyese, tregtare”, kurse të mbetet vetëm “prodhuese”. Pastaj kërkoi që neni 4 të riformulohet më mirë. Në fund në emër të grupit asambleistë të LDK-së propozoi që të formohet një komision prej ekspertëve i

cili do t'i përgatit kriteret për formën se si do të shpallet tenderi, cilat kriteret duhet t'i përmbushë ai ofertues i cili do të konkurroj për marrjen në shfrytëzim të kësaj patundshmërie.

Sami Istrefi- tha se grupi asambleistë i PDK-së e mbështet këtë propozim dhe propozojmë që kohëzgjatja e afatit të jetë 20 vite, për shkak se nëse iu ipet mundësi bizneseve që të zhvillohen, me 10 apo 15 vite askush nuk do të hyn aty. Pastaj e përkrahu formimin e një komisioni profesional të cilin duhet ta udhëheq Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi.

Muharrem Shabani- duke iu referuar thënies së drejtorit që kjo çështje është në pajtim me Kryetarin, këtu askund nuk shihet se është në pajtim me Kryetarin, pasi që nuk ka nënshkrim të Kryetarit. Pastaj tha që në këtë vendim duhet të jetë edhe një nen i veçantë "personat që kanë uzurpuar atypari prona, t'iu ndalohej e drejta e tyre, sepse kanë shkelur ligjin, që mos t'iu ipet në shfrytëzim, por të lirohet nga personat që është uzurpuar", pasi që ka dyshime se po mendohet që në baza të ndryshme me iu dhënë prona atyre që e kanë uzurpuar më herët. Gjithashtu kërkoi që të dihen kushtet.

Tasim Gubetini- propozoi që kohëzgjatja të neni 2 të hiqet krejt, për të qenë më atraktiv për investitorë, pasi që kohëzgjatjen e caktojmë në bazë të veprimtarisë. Në fund kërkoi që të shpallet tenderi për dhënien me kompensim.

Zeqir Hasani- tha se me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe të punësimit, duhet që Komuna dhe Kuvendi të jenë shumë transparent në zgjedhjen e ofertuesve në rast të dhënies së këtyre parcelave. Pastaj kërkoi që decidivisht të ceket vetëm për lëmi prodhuese. Gjithashtu pajtohet që minimumi të jetë 20 vite, pasi që kapitali i investuar mund të amortizohet vetëm brenda 20 viteve.

Sabit Kadriu- tha se Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e bjen vetëm skicën, ndërsa duhet të involvohen edhe Drejtoria për Bujqësi, Drejtoria për Urbanizëm, dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor. Pastaj mbështeti që të jetë për veprimtari prodhuese, por është kundër asaj që të zihen tokat e bukës.

Ferit Idrizi- pajtohet që të formohet komisioni për përgatitjen e kushteve për shpalljen e tenderit dhe propozoi që të jetë edhe drejtori i ekonomisë dhe zhvillimit, drejtori i urbanizmit dhe drejtori i kadastrit. Pastaj propozoi që kohëzgjatja të jetë 20 vite me mundësi vazhdimi dhe të zhvillohen veprimtari prodhuese.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

a. Formohet komisioni për caktim të kushteve dhe kriterëve për shpallje të tenderit për pronën në fjalë, në këtë përbërje: Refik Ramaj, Zeqir Hasani, Gani Imeri, Selim Rustemaj, Nasuf Aliu, Idriz Ismajli, Nezir Klinaku.

b. Afati për dhënien në shfrytëzim – 20 vite me mundësi të vazhdimit.

c. Prona në fjalë të ipet në shfrytëzim vetëm për veprimtari prodhuese.

9. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për dhënien me koncesion të pronës së paluajtshme të komunës.

Muharrem Shabani- tha se kur është caktuar urgjent trualli për familjet e Dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës, është thënë që do të gjenden mjetet, vetëm u kërkua që të votohet nga Kuvendi. Pastaj tha që kjo të bëhet në mënyrë urgjente dhe transparente, dhe së bashku me shoqatat, me anëtarët e Kuvendit dhe me anëtarët e qeverisë të formohet një trupë e përbashkët që e kontrollon dhe mbikëqyrë tërë këtë situatë.

Sami Istrefi- lidhur me dispozitat ligjore, tha se nëse i kemi 40 vite me mundësi vazhdimi 10 vite, pyeti çka pastaj, kush i merr ato ndërtesa dhe ku do të shkojnë ato familje që janë të vendosura në ato objekte. Pastaj tha se nuk është cekur neni 8 që flet për kohëzgjatjen. Në fund propozoi që ky propozimvendim të përkrahet dhe të gjithë të bashkohemi në një trupë për të dhënë kontributin tonë.

Veli Karaça- tha se grupi asambleistë i LDK-së e mbështet këtë propozimvendim dhe kërkon që të respektohen të gjitha procedurat ligjore në afatin sa më të shkurtër.

Ferit Idrizi- propozoi që komisionit që u formua më parë t'iu bashkëngjiten edhe dy anëtarë, një nga familja e Dëshmorëve, një nga invalidët e luftës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

a. Formohet komisioni për caktim të kushteve dhe kriterëve për shpallje të tenderit për pronën në fjalë, në këtë përbërje: Sabri Ferati, Ismet Gashi, Mejreme Ismajli, Safet Idrizi, një përfaqësues nga shoqata e familjeve të Dëshmorëve dhe një përfaqësues nga shoqata e invalidëve të luftës.

b. Afati për dhënien në shfrytëzim – 40 vite me mundësi të vazhdimit në afat të caktuar ligjor.

10. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për plotësim të vendimit të KK-së për ndryshim të rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Muharrem Shabani- tha se ka shumë ndryshime dhe plotësime, prandaj është koha që të akumulohen ato dhe të bëhet një rregullore complete. Pastaj sugjeroi që të hiqet termi “asamble” dhe në vend të tij të përmendet termi “kuvend”.

Ismet Gashi- duke iu referuar nenit 2, i cili është bazuar në nenin 27.4, propozoi që ai nen, certifikatat sanitare duhet të hiqet krejt, pasi që lëshohet një aktvendim prej Drejtorisë së Inspektionit për plotësimin e kushteve minimale higjieno-teknike të lokaleve që i plotësojnë kushtet për veprimtari të biznesit. Kurse nëse mbetet ashtu, e mbetet certifikata, pyeti për certifikatat sanitare të cilat i lëshon Drejtoria e Inspektionit lidhur me projektet për leje ndërtimore, a do të thotë që vlejné këto çmime?, duke shtuar se nëse vlejné, kjo është tepër e madhe.

Bajram Beqiri- kërkoi falje për gabimin e lëshuar teknik në seancën e kaluar, pasi që ky vendim ka kaluar në seancën e kaluar, por i ka munguar kjo fjali, dhe pikërisht ka të bëjë për pëlqimet sanitare, për kushtet higjienike dhe teknike të lokaleve afariste. Pastaj njoftoi se vetëm shpenzimet administrative, pra vetëm kërkesa paguhet, jo edhe munda dhe puna e inspektionit që bën pranimin e lokaleve.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet propozimvendimi si në tekstin e paraqitur nga Drejtoria për Inspektion.

11. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për plotësim të vendimit të KK-së për shpalljen e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës.

Muharrem Shabani- tha se kjo formë dhe ajo si është hyrë kemi qenë kundër si grup asambleistë i AAK-së që të jepen 1.60 hektarë tokë të punueshme, nën komosacion, nën ujitje me i shndërruar në tokë ndërtimore, dhe shtoi se ka dyshim që një pjesë e asaj toke është e uzurpuar. Pastaj njoftoi se më herët për pjesën kur iu është ndërruar destinimi kaher, grupi asambleistë i AAK-së e ka përkrahur. Në vazhdim tha se këtë çështje e kemi qit me datën 31.07 në bazë të një vendimi që ka nxjerr Drejtoria për Marrëdhënie pronëso-ro-juridike, dhe e drejta e ankesës ka qenë 30 ditë, dhe kjo tokë iu është marrë kompanisë ELAN. Gjithashtu tha se tokën bujqësore duhet ta mbrojmë, duhet të respektohen edhe dispozitat e ligjit, prandaj si grup përsëri deklaroi që janë për afatin edhe më të madh nëse është për destinim prodhimi, pra grupi i tij asambleistë është për pjesën prej 40 ari, ndërsa për pjesën tjetër jo. Në fund shtoi se në këtë proces vërehet mungesa e Kryetarit të Komunës.

Ismet Gashi- kërkoi që në dispozitat mbështetëse të mos figuron “Gazeta Zyrtare të KSAK”, pasi që në bazë të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës thuhet se kur të zbatohen ligjet e zbatueshme duhet të ceket Gazeta Zyrtare e Kosovës.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për”, 7 “kundër”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: *Aprovohet vendimi në fjalë duke ia shtuar nenit 2 të vendimit të ndryshuar këtë fjali: në kohëzgjatje prej 20 vitesh me mundësi vazhdimi.*

Gjithashtu vendimit në fjalë i shtohet një nen me këtë përmbajtje: Pas skadimit ose ndërprerjes së parakohshme të afatit të dhënies së pronës në shfrytëzim, prona e cila ipet në shfrytëzim duke përfshirë edhe pronën e paluajtshme të marrësit në shfrytëzim (investitorit), mbetet në pronësi të Komunës së Vushtrrisë.

12. Eventuale.

Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Selvete Sholla- paraqiti dy kërkesa: deri kur do të lejohet ndërprerja kolektive e energjisë elektrike, pse të sanksionohen të gjithë banorët për hir të disave që nuk e paguajnë. Gjithashtu kërkoi që projekti që ka filluar para më shumë se dy viteve dhe që është ndërprerë në vendin e ashtuquajtur Podrançe, dhe shtoi se në këtë vend derdhen rreth 50 % të ujërave të zeza të qytetit, dhe në këtë rrugë shumë fëmijë shkojnë nëpër shkolla, dhe shumë lehtë mund të vjen edhe deri te përhapja e sëmundjeve të ndryshme, prandaj kërkoi që sa më shpejt të vazhdoi ky projekt.

Sami Istrefi- propozoi që të veprohet njëjtë sikur Kryetari i Komunës së Prishtinës, i cili ka nxjerr një vendim për lejimin e mjeteve financiare për shujtën ditore të shërbyesve civil të komunës. Prandaj propozoi që t’i propozohet Drejtorisë së Administratës që drejtori i administratës të shkon me propozim konkret te Kryetari i Komunës dhe të nxjerret një vendim për shujtën ditore në vlerë prej 2 € për shërbyesit civil të komunës.

Besim Jashari- pasi që ka mungesë të theksuar të hapësirave publike në qytet, propozoi që si Kuvend të shikohet mundësia që ish-sipërfaqja që i ka takuar më parë drejtorisë së pylltarisë me u shpallë zonë me interes publik dhe të bëhet park. Pastaj në seancën e datës 29.04 e ka ngritur shqetësimin e të gjithë banorëve në rrugën “Mehmet Konjuhi” që takohet me rrugën “Zahir Pajaziti”, pjesa e mbrojtjes së lumit Tërstena, në tre vende janë të hapur tre shakta, dhe paraqet rrezik për fëmijët, kurse në anën tjetër të lumit janë tre shakta tjerë, që njëri prej tyre është i mbuluar me dërrasa të improvizuara, prandaj kërkoi urgjentisht që kësaj t’i ipet prioritet dhe të merren masa të menjëhershme. Mandej pjesa që po rregullohet si shëtitore kah lumi Sitnica, tha se atje është thertorja dhe afër thertoreshes ka eshtra, kurse në hyrje të kryqëzimit të rrugës “Mehmet Konjuhi” dhe “Zahir Pajaziti” janë mbledhë dy renda drunj dhe aty është vendosur një grumbull i mbeturinave, për këtë arsye kërkoi urgjentisht nga Drejtoria e Inspektionit, Shërbimeve Publike, në krye me Kryetarin të marrin masa të menjëhershme për ta bërë atë hapësirë të këndshme për njerëzit. Në vazhdim përmendi funksionimin për më tepër se një vit të disa shkollave pa emër dhe akoma funksionojnë pa emër, dhe kërkoi që menjëherë të merren masa dhe t’iu ngjiten emrat shkollave në fjalë. Duke iu referuar një deklaratë publike para Kuvendit të S.Kadriut se Komuna e Vushtrrisë prin për nga zënia e sipërfaqeve bujqësore me objekte ndërtimore, pyeti se a është kjo e vërtetë, e nëse është e vërtetë të stopohet ky trend negativ. Gjithashtu duke iu referuar një deklaratë të Z.Hasanit se prej 1260 bizneseve janë të pajisura me leje pune vetëm 10 % të bizneseve, tha se kjo shtron një përgjegjësi për drejtorinë përkatëse që këto biznese të pajisen me leje. Në fund kërkoi që të merren masa dhe të mbyllen gropat në rrugën “Dëshmorët e Kombit”.

Qazim Azemi- në emër të grupit asambleistë të AAK-së kërkoi informatë lidhur me 70 fermerët, bujqit e dëmtuar nga vërshimet, dhe pyeti se a është ndërmarrë diçka për ta, ndonjë ndihmë, apo beneficion? Pastaj kërkoi informatë me shkrim se si janë formuar bordet e ndërmarrjeve komunale, kush i ka zgjedhur dhe a është respektuar ligji? Mandej tha se ende nuk kemi përgjigje për vizitën në Turqi, nuk ka raport kush

e ka organizuar dhe qëllimi i vizitës. Gjithashtu nuk kemi përgjigje të plotë rreth emërimit të drejtorëve për 32 shkolla. Nuk kemi përgjigje të plotë për pronën komunale në komunën kadastrale Sfaraqaku i Poshtëm. Mandej kërkoi që të ketë transparencë për punën e këtij Kuvendi, dhe të angazhohet ndonjë televizion për përcjelljen e seancave. Në fund tha se informatën për debatin me qytetarë e kemi marrë vonë, edhe pse neni 68 thotë që duhet 2 javë më herët të informohen.

Sabit Kadriu- tha se ka kërkuar siguri në magjistralen që e lidh Vushtrrinë me Skenderaj, pasi që atje nuk ka shenja të komunikacionit, dhe vozitja e shpejtë e veturave rrezikon për çdo ditë jetën e qytetarëve, prandaj kemi kërkuar që patrullat e policisë të dalin dhe të lëvizin edhe në këto pjesë, dhe në mungesë të patrullave policore në Duboc, Beqiriq kanë dalë njerëz të papërgjegjshëm duke i ngacmuar vajzat dhe duke i joshur me të holla që të futen në veturën e tyre, dhe për këtë arsye kërkoi që të vjen të raportoi në seancën e radhës në Kuvend komandanti i policisë për komunën. Mandej paraqiti vërejtje për shkyçjet kolektive të energjisë elektrike, prandaj duhet bërë presion te KEK-u përmes Komunës, dhe njoftoi për gjendjen shumë të rëndë të shtyllave elektrike në fshatin e tij, duke kërkuar që disa shtylla elektrike që janë hequr nga qyteti të dërgohen dhe të futen në funksion nëpër viset rurale.

Veli Karaça- kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që në seancën e radhës t'i shohim rezultatet e gjysmëvjetorit të dytë dhe të bëjmë një krahasim me gjysmëvjetorin e parë, që ta kuptojmë sa është përmirësuar cilësia e mësimdhënies. Pastaj për Drejtorinë e Urbanizmit, pasi që tha se Kuvendi ka marrë një vendim për shpalljen e zonës industriale në Lummadh, pyeti a ka ndonjë projekt ideor, pasi që ka shumë biznese të interesuar që ta zhvillojnë dhe zgjerojnë veprimtarinë në këto parcela që kanë qenë të shkëputura nga ajo zonë, dhe pyeti se a ka kapacitete drejtoria, a është duke bërë diçka Komuna që ta bëjmë një elaborat për zonën industriale që t'iu ofrojmë bizneseve mundësi për zgjerimin e veprimtarive të tyre?

Mbledhja përfundoi në orën 16:25.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi